



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA FIER**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më \_\_\_/ \_\_\_/ 2020

**Lënda:** Formulari i Njoftimit të Fituesit për procedurën me objekt **“Rehabilitimi i skemës ujëtare, dega e Martinës (faza 1)”** me burim financimi nga Buxheti i Shtetit

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**  
**TIRANË**  
**(për botim)**

**BASHKIA FIER**

**Për:** Bashkimin e operatorëve ekonomik **“ELMAZAJ KONSTRUKSION”** shpk & **“LUSHAKU-09”** shpk

Përfaqësuar me prokurë të posaçme nga **“ELMAZAJ KONSTRUKSION”** shpk,

**Adresa:** L. "1 Maji", Rr. "Jani Bakalli", zona kadastrale 8531, Nr. pasurie 5/399-N15, Pallati nr.88, Ap 39, Fier.

**\*\*\***

Procedura e prokurimit: **Procedurë e Hapur me mjete elektronike**

Numri i referencës së procedurës / lotit : **REF-68316-08-11-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi i skemes ujëtare, dega e Martinës (faza 1)”**, me fond limit **33 234 536** (tridhjetë e tre milion e dyqind e tridhjetë e kater mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, objekti do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë brenda grafikut të punimeve, por financimi do të bëhet në 2 (dy) vite buxhetore (2020-2021), me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, në perputhje me Projektin, Preventivin dhe kushtet e përcaktuara në DST. Afati kohor për ekzekutimin e punimeve: jo më vonë se 4 (katër) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [17 Gusht 2020] [Numri 55]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët- **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“BEQIRI”** shpk numri i NUIS J98624801V & **“METEO”** shpk numri i NUIS L26310801C.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **27 458 623** (njëzetë e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzetë e tre) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori ekonomik **“ALUERA”** shpk numri i NUIS K33222403W.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **33 187 763.72** (tridhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik **“FLED”** shpk, numri i NUIS K17621104C.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **23 674 622** (njëzetë e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy) **lekë pa TVSH.**

4. Operatori ekonomik **“SHENDELLI”** shpk, numri i NUIS K07924803N.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **26 458 464** (njëzetë e gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e kater) **lekë pa TVSH.**

5. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“GENERAL BETON”** shpk numri i NUIS K23013401A & **“ED KONSTRUKSION”** shpk numri i NUIS K61625001I.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **24 206 218** (njëzetë e katër milion e dyqind e gjashtë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

6. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“ELMAZAJ KONSTRUKSION”** shpk numri i NUIS L33229401T & **“LUSHAKU-09”** shpk numri i NUIS K92605402O.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **30 225 815.5** (tridhjetë milion e dyqind e njëzetë e pesë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë presje pesë) **lekë pa TVSH.**

7. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“K.M.K.”** shpk numri i NUIS L78223801E & **“2 N”** shpk numri i NUIS L31615017L.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **20 701 075** (njëzetë milion e shtatëqind e një mijë shtatëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**

8. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“ARDIT - 06”** shpk numri i NUIS K63027403V & **“AGBES KONSTRUKSION”** shpk numri i NUIS K32807432W.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **33 183 257.1** (tridhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë presje një) **lekë pa TVSH.**

**9. Operatori ekonomik “LLAZO” shpk numri i NUIS K24218401K.**

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **22 437 591.16** (njëzetë e dy milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një presje gjashtembedhjetë) **lekë pa TVSH.**

**10. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” shpk numri i NUIS K71820009I.**

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **25 912 267.1** (njëzetë e pesë milion e nentëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtedhjetë e shtatë presje një) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1) Bashkimi i operatorëve ekonomik “K.M.K.” shpk numri i NUIS L78223801E & “2 N” shpk numri i NUIS L31615017L.**

BOE “K.M.K.” shpk & “2N” shpk nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST, ne kuptim te nenit 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

KMK shpk, si anëtari me perqindjen me te madhe te pjesmarrjes ne bashkim, ne kuptim edhe te kerkeses per kualifikim dhe rregullit te prokurimit te percaktuar ne DST se “Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim”, nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST, pasi kontratat e paraqitura nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit, ndersa kontrata me Bashkine Peshkopi me objekt “Sherbime mirembajtje, ndertime, rehabilitime te kanaleve ujtese ne Bashkine Diber”, me vlere 6 282 407 leke pa TVSH, e cila vleresohet si pune e ngjashme, ne te cilen KMK shpk ka 42% pjesmarrje (sipas Formularit te Vleresimit), ne baze te perlllogaritjeve, pjesa takuese e realizimit te kesaj kontrtate eshte 2 638 610 leke pa tvsh, pra eshte në një vlerë më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës objekt prokurimi.

Tek kontrata e paraqitur nga KMK shpk “Reabilitim i kanalit KUL F.I”, OE K.M.K shpk rezulton ne cilesine e nenkontraktorit te kontraktorit “Caushi” shpk, ku Investitor per kete kontrate rezulton te jetë Bashkia Durres, pra eshte nje investim apo kontrate publike qe i nenshtrohet rregullave te prokurimit publik. Ne kete kuptim, OE K.M.K shpk ka detyrimin ligjor, qe se bashku me dokumentat e nenkontraktimit, duhet te paraqiste ne oferte edhe dokumentacionin ligjor te percaktuar nga neni 75 i VKM nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, (pra kontraten e kontraktorit me Bashkine Durres), pasi në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës bazë.

Ne baze te nenit 75 te VKM nr.914 date 29.12.2014, kontrata midis kontraktorit dhe nenkontraktorit duhet te jete e noterizuar, gje qe nuk rezulton e tille ne rastin konkret. Formulari i Vleresimit sipas Shtojces 8 per kete rast duhej te leshohej nga Investitori (Bashkia Durres), sic percakton neni 75 i VKM nr.914 date 29.12.2014 dhe Formulari tip ne DST, dhe jo nga kontraktori.

BOE “K.M.K.” shpk & “2N” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion shoqerues te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim “kontrate/marrëveshje noteriale furnizimi me nje subjekt qe

*operon per prodhimin e betonit*” te percaktuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, BOE “K.M.K.” shpk & “2N” ka paraqitur kontrate furnizimi me subjektin “SINA 98” shpk, por nuk e ka shoqeruar kontraten e furnizimit me certifikaten e pronesie se objektit, dokumentacion per kalibrimin i impiantit te betonit (peshave), sic jane kerkuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

Gjithashtu, BOE “K.M.K.” shpk & “2N” ka paraqitur kontrate furnizimi me subjektin “Ferro Beton” shpk, por nuk e ka shoqeruar kontraten e furnizimit me certifikaten e pronesie se objektit, faturat e blerjes se pajisjeve, dokumentacion per kalibrimin i impiantit te betonit (peshave), sic jane kerkuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

BOE “K.M.K.” shpk & “2N” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim *“Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në mjetet që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”*, te percaktuar ne piken 2.3.5, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për mjetet që shënohen në regjistrat publikë (*me targë*), per te cilet Ofertuesi duhet ti shoqerorë gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, konstatohet se certifikatat e lëshuara nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar **“Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak”**, nderkohe qe, te 2 anetaret e BOE i kane marr me qera mjetet kamion, autopompe apo autobetonier, sic rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe Shtojcat 10 te secilit anetar te BOE.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me këtë mjet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

Gjithashtu, per mjetin autopompe me targë TR8695H mungon Leja e Transportit, per mjetin kamion me targë AA149ZO Leja e Transportit e paraqitur eshte per nje mjet tjetër me targë BR4864B, per mejetet me targa TR0516N, TR4364P, TR4397P, TR5385P, TR5964K, mungojne taksat vjetore.

## 2) Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” shpk numri i NUIS K71820009I.

OE “LEON KONSTRUKSION” shpk nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST. Kontrata e paraqitur me objekt “Rehabilitimi i infrastruktures dhe restaurimi i kalldrëmeve ne Pazarin e Gjirokastrës”, nuk vleresohet e ngjashme me objektin e prokurimit.

OE “LEON KONSTRUKSION” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim *“Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në mjetet që*

*nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, te percaktuar ne piken 2.3.5, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te mjeteve te parqitura nga ofertuesi, si dhe nga deklarimet ne Shtojcen 10 ”Mbi disponimin e makinerive”, eshte konstatuar se mjetet autobetonier me targe AA693RV, autobetonier me targe AA694RV dhe autopompe betoni me targe AA691JC, te cilat ofertuesi i ka marr me qira nga subjekti ”Aliko Ndertimi” shpk, sipas kontrates noteriale perkatese, ky i fundit, pra Qeradhenesi ”Aliko Ndertimi” shpk ia ka dhene me qira edhe dy subjekteve ofertues ne kete procedure prokurimi (SHENDELLI shpk dhe BEQIRI shpk). Pra, keto mjete jane deklaruar te disponueshme per realizimin e kontrates me objekt ”Rehabilitimi i skemës ujitëse, dega e Martinës (faza 1)”, nga 3 (tre) ofertues pjesmarres ne kete procedure, gje qe vjen ne kundërshtim me rregullat e prokurimit dhe deklarimet e secilit prej ketyre ofertuesve mbi angazhimin apo disponueshmerine e mjeteve, per kete procedure prokurimi.

OE ”LEON KONSTRUKSION” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion shoqerues te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim *”kontrate/marrëveshje noteriale furnizimi me nje subjekt qe operon per prodhimin e betonit”* te percaktuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, ofertuesi ka paraqitur kontrate furnizimi me subjektin ”Alba Beton” shpk, por nuk e ka shoqeruar kontraten e furnizimit me certifikaten e pronësie se objektit, , sic eshte kerkuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

### 3) Operatori ekonomik ”SHENDELLI” shpk, numri i NUIS K07924803N

OE ”SHENDELLI” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim *”Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 ose për vitin 2020 (për këstet e maturuara), prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB”* te percaktuar ne piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit ofertuesi ka paraqitur vertetim nga Bashkia Tirane me nr.184995/1 date 14.08.2019, ku thuhet se ky subjekt nuk rezulton te kete te hapur adrese ne Tirane deri ne kete date, nderkohe qe referuar Ekstraktit Historik te subjektit ofertues, rezulton me aktivitet ne Bashkine Tirane, sipas ceshtjeve te hapura ne datat 06.12.2019 dhe 30.12.2019, qe do te thote se per keto ceshtje te hapura ne fund te vitit 2019, subjekti duhet te paraqiste vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Tirane, per periudhen ne vazhdim, sic eshte kerkuar ne piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

OE ”SHENDELLI” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim *”Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në mjetet që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”,* te percaktuar ne piken 2.3.5, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te mjeteve te parqitura nga ofertuesi, si dhe nga deklarimet ne Shtojcen 10 ”Mbi disponimin e makinerive”, eshte konstatuar se mjetet autobetonier me targe AA693RV, autobetonier me targe AA694RV dhe autopompe betoni me targe

AA691JC, te cilat ofertuesi i ka marr me qira nga subjekti "Aliko Ndertimi" shpk, sipas kontrates noteriale perkatese, ky i fundit, pra Qeradhenesi "Aliko Ndertimi" shpk ia ka dhene me qira edhe dy subjekteve ofertues ne kete procedure prokurimi (LEON KONSTRUKSION shpk dhe BEQIRI shpk). Pra, keto mjete jane deklaruar te disponueshme per realizimin e kontrates me objekt "Rehabilitimi i skemës ujitëse, dega e Martinës (faza 1)", nga 3 (tre) ofertues pjesmarres ne kete procedure, gje qe vjen ne kundërshtim me rregullat e prokurimit dhe deklarimet e secilit prej ketyre ofertuesve mbi angazhimin apo disponueshmerine e mjeteve, per kete procedure prokurimi.

OE "SHENDELLI" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion shoqerues te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim "*kontrate/marrëveshje noteriale furnizimi me nje subjekt qe operon per prodhimin e betonit*" te percaktuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, ka paraqitur kontrate furnizimi me subjektin "EUROBETON" shpk, por nuk e ka shoqeruar kontraten e furnizimit me dokumentacion per kalibrimin i impiantit te betonit (peshave), certifikimi ISO 9001:2015, sic jane kerkuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

Gjithashtu, ka paraqitur kontrate furnizimi me subjektin "Vllezerit LLupo" shpk, me aktivitet perpunim guri, jo me lejet perkatese per objektin e prokurimit, si dhe nuk e ka shoqeruar kontraten e furnizimit me dokumentacion per kalibrimin i impiantit te betonit (peshave), certifikimi ISO 9001:2015, sic jane kerkuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

- 4) Bashkimi i operatorëve ekonomik "BEQIRI" shpk numri i NUIS J98624801V & "METEO" shpk numri i NUIS L26310801C.

BOE "BEQIRI" shpk & "METEO" shpk, ne formularin e ofertes se dorezuar nga BOE eshte nderhyre dhe jane ndryshuar volumet e disa zerave te preventivit konkretisht: Nr.3, 5, 6, 7, 8, 9, duke ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi ka shtuar ose ulur sasi të zërave konkretë të tij.

Neni 51 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon autoritetin kontraktor të modifikojë ofertën, duke ndryshuar sasinë e zërave të punimeve në preventiv. Gjithashtu sic parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme". Neni 66 pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar ka të bëjë me gabimet aritmetike: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij ose nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabim aritmetik, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasinë e preventivit, dhe si pasojë kjo oferte vlerësohet e pavlefshme.

OE "BEQIRI" shpk, anëtar i BOE "BEQIRI" shpk & "METEO" shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim "*Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 ose për vitin 2020 (për këstet e maturuara)*", prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron

apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB” te percaktuar ne piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, referuar Ekstraktit Historik te subjektit ofertues, rezulton me aktivitet ne Bashkine Durres, por ky subjekt nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor as për vitin **2019** dhe as për vitin **2020 (për këstet e maturuara)**, nga Bashkia Durres, sic eshte kerkuar ne piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

OE “METEO” shpk, anëtar i BOE “BEQIRI” shpk & “METEO” shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri” te percaktuar ne piken 2, 1/gj, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

OE “METEO” shpk ka paraqitur vertetim nga FSHU (OSHEE Group) me nr.529/1 date 31.08.2020, sipas se ciles deklarohet se ky subjekt nuk rezulton mbajtes i nje kontrate per furnizimin me energji elektrike. Ky konstatim, vjen ne kundërshtim me rregullat e prokurimit publik te percaktuara ne VKM nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe ne kontradiktë me faktin se vet subjekti “METEO” shpk, ka paraqitur ne kete tender dokumentacion per aktivitet pike e prodhimit te betonit, sipas lejeve perkatese, certifikates se pronesise, etj., ne adresen pasuria nr.6/76, zona kadastrale nr.1362, fashati Çekin, Gramsh.

BOE “BEQIRI” shpk & “METEO” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion shoqerues te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim “kontrate/marrëveshje noteriale furnizimi me nje subjekt qe operon per prodhimin e betonit” te percaktuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Konkretisht, ka paraqitur dokumentacionin e pronesise se “METEO” shpk, por nuk e ka shoqeruar me dokumentacion per kalibrimin i impiantit te betonit (peshave), certifikimi ISO 9001:2015, sic jane kerkuar ne piken 2.3.7, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit.

BOE “BEQIRI” shpk & “METEO” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në mjetet që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, te percaktuar ne piken 2.3.5, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te mjeteve te parqitura nga ofertuesi, si dhe nga deklarimet ne Shtojcen 10 ”Mbi disponimin e makinerive”, eshte konstatuar se mjetet autobetonier me targe AA693RV dhe autopompe betoni me targe AA691JC, te cilat ofertuesi i ka marr me qira nga subjekti ”Aliko Ndertimi” shpk, sipas kontrates noteriale perkatese, ky i fundit, pra Qeradhenesi ”Aliko Ndertimi” shpk ia ka dhene me qira edhe dy subjekteve ofertues ne kete procedure prokurimi (LEON KONSTRUKSION shpk dhe SHENDELLI shpk). Pra, keto mjete jane deklaruar te disponueshme per realizimin e kontrates me objekt “Rehabilitimi i skemës ujitëse, dega e Martinës (faza 1)”, nga 3 (tre) ofertues pjesmarres ne kete procedure, gje qe vjen ne kundërshtim me rregullat e prokurimit dhe deklarimet e secilit prej ketyre ofertuesve mbi angazhimin apo disponueshmerine e mjeteve, per kete procedure prokurimi

BOE “BEQIRI” shpk & “METEO” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per leje drejtimi per drejtuesit e mjeteve (sipas kategorise perkatese), siç eshte kerkuar ne piken 2.3.5/a, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

5) Operatori ekonomik “FLED” shpk, numri i NUIS K17621104C.

OE “FLED” shpk nuk ka paraqitur dokumentat plan – organizimin e punes dhe metodologjine e punimeve në objekt, siç janë kerkuar ne piken 2.3.9 te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

6) Bashkimi i operatorëve ekonomik “ARDIT - 06” shpk numri i NUIS K63027403V & “AGBES KONSTRUKSION” shpk numri i NUIS K32807432W.

BOE ARDIT 06 shpk & AGBES KONSTRUKSION shpk, nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky ofertues ka paraqitur 2 (dy) preventiva dhe si rrjedhoje 2 (dy) oferta ekonomike, brenda se njejtës oferte, per kete procedure prokurimi publik.

Konkretisht, eshte paraqitur preventive me vleren 22 497 049.06 leke pa TVSH, si dhe eshte paraqitur preventive me vleren 33 183 257.1 leke pa TVSH.

Ne keto kushte, bazuar ne piken 13/a, te nenit 3 të LPP-së, ne nenet 51 - 55 të LPP-së, ne piken 3 te nenit 63 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik*” i ndryshuar, si dhe ne piken 1.7 te dokumentit te DST “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, kjo oferte refuzohet.

7) Operatori ekonomik “ALUERA” shpk numri i NUIS K33222403W.

OE “ALEURA” shpk nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST, ne kuptim te nenit 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik*” i ndryshuar.

Kontrata e paraqitur nga subjekti nuk janë te ngjashme me objektin e prokurimit.

OE “ALEURA” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per taksat vendore, bilancet, vertetim nga OSHEE, vertetim xhiro, dokumentacion per nyje betoni, dokumentacion per mjetet, plan – organizimin e punes dhe metodologjine e punimeve në objekt, siç percaktohet ne rubriken 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

8) Operatori ekonomik “LLAZO” shpk numri i NUIS K24218401K.

Bazuar ne nenin 56 te LPP-së, si dhe ne kushtet qe nga ana e subjektit ofertues nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion (*pas kerkeses se bere nga AK*), ne menyre qe te argumentoje oferten anomalisht te ulet (*në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), Oferta e subjektit ofertues LLAZO shpk, vleresohet si oferte anomalisht e ulet. Ky fakt, bazohet edhe ne kthimin e pergjigjes se subjektit tuaj per mosparaqitje argumentimi, nr.459 prot date 23.09.2020.

9) Bashkimi i operatorëve ekonomik “GENERAL BETON” shpk numri i NUIS K23013401A & “ED KONSTRUKSION” shpk numri i NUIS K61625001I.

Më datë 15.09.2020 ne autoritetin kontraktor Bashkia Fier, eshte protokolluar shkresa e subjektit ofertues BOE GENERAL BETON shpk & ED KONSTRUKSION shpk, me lëndë “*Kërkesë tërheqje*” (*protokoll nr.6755 date 15.09.2020*), me anë të së cilës parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi “*Rehabilitimi i skemes ujitesë, dega e Martines (faza 1)*”.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili në nenin 94,



“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës, është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga ky operatorë ekonomik.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomik “**ELMAZAJ KONSTRUKSION**” shpk numri i NUIS L33229401T & “**LUSHAKU-09**” shpk numri i NUIS K92605402O, perfaqesuar me prokure te posaçme nga “**ELMAZAJ KONSTRUKSION**” shpk, Adresa: L."1 Maji", Rr. “Jani Bakalli”, zona kadastrale 8531, Nr. pasurie 5/399-N15, Pallati nr.88, Ap 39, Fier, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **30 225 815.5** (tridhjetë milion e dyqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë presje pesë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Njësisë së Prokurimit të Bashkisë Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **23.09.2020**.

Ankesa: ka ose jo, - **PO**.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë :

Ankese nga OE “SHENDELLI” shpk protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.7191 prot., dt.28.09.2020, ka marrë përgjigje nga AK me shkresë nr.7191/5 prot. datë 02.10.2020.

Ankese nga OE “LEON KONSTRUKSION” shpk protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.7192prot., dt.28.09.2020, ka marrë përgjigje nga AK me shkresë nr.7191/6 prot. datë 05.10.2020.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

\_\_\_\_\_  
**Armando SUBASHI**